



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.172/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Afijete Sada-Gillogjani dhe Ymer Hoxha anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e zyrtarit ligjor Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Podujevë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 12.10.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Prishtinë, dhe subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Podujevë, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 1,600.00 (*njëmijë e gjashtëqind*) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimi të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

### A r s y e t i m

Me datën 10.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me të cilën pretendon se me datën 09.10.2017, rreth orës 11:15, në sheshin qendror, më konkretisht pranë objektit të komunës së Podujevës aktivistë nga radhët e subjektit politik LVV kanë vendosur tendën dhe tavolinën me material zgjedhor, përfshirë banera me foto dhe logo të subjektit politik LVV.

Parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së nenit 33 pika b të LZP-së dhe Nenit 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe 3.4 të Rregullës 13/2014.

Në cilësi të provës si dëshmi ka bashkangjitur një fotografi të printuar lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 11.10.2017 subjekti politik LVV, thekson se pas njoftimit lidhur me ankesën e parashtruar nga subjekti politik LDK, kemi ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme duke i njoftuar aktivistët tanë për të evituar shkeljet e bëra . Subjekti politik LVV në mes tjerash ka shtuar se tenda e vendosur në qendër të qytetit nuk ka qëndruar më shumë se 1 orë. Si dëshmi ka bashkangjitur 4 fotografi me të cilat shihet se është larguar tenda nga vendi ku ka qenë i vendosur.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

### **Ankesa është e bazuar**

Nga fotografia e ofruar si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se tenda e vendosur me përmbajtje zgjedhore nga subjekti politik LVV është vendosur në vende publike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton: *“Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugë publike.*

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë, Paneli konstaton se nga prova e ofruar shihet qartë se nga ana e subjektit politik LVV, është shkelur neni 33 pika (b) të LZP-së, pasi që tenda e vendosur me përmbajtje zgjedhore nga subjekti politik në fjalë, është vendosur në vende publike, të cilën shkelje e ka pranuar edhe vet subjekti politik LVV në përgjigjen në ankes të datës 11.10.2017

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjekti politik LVV, ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe se përkundër këtij fakti tenda e vendosur nga subjekti politik LVV është vendosur në vende publike. Po ashtu si rrethanë Paneli mori edhe faktin se subjektit politik në fjalë ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërruar veprimet për të bërë përmisimin e shkeljes ashtu që kanë larguar tendën nga vendi i palejuar ku ka qenë i vendosur ai, i cili veprim ka ndikuar në lartësin e gjobës së shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

ZL. Anr.172/2017 më datën 12.10.2017



**Kryesuesi i Panelit**  
Fejzullah Rexhepi

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.